



This project is funded
by the European Union



Autoriteti Kontraktues: **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**

Thirrje e Hapur për Projekt - Propozime

Raundi i Tretë

Udhëzues për Aplikantët

Projekti EMBRACE - Modele Sipërmarrjeje që Ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese

Referenca në Buxhet:

Nr. i Kontratës së Grantit 2017/394-895

Financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri në kuadër të Mbështetjes për Shoqërinë Civile –
IPA Civil Society Facility and Media Programme 2016-2017

Afati i dorëzimit të aplikimeve:

4 Shkurt 2020 në 17:00

NJOFTIM

Kjo është një thirrje e hapur ku të gjitha dokumentet duhen dërguar së bashku.

Në hapin e parë do të vlerësohet vetëm përputhshmëria e dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe të dërguara bashkarisht me aplikimin. Në vijim, do të vlerësohet aplikimi i plotë për aplikantët që kalojnë fazën e parë të përzgjedhjes.

Udhëzimet e përshkruara në këtë dokument do të ndihmojnë të gjithë aplikantët të dërgojnë aplikimet e tyre në mënyrë të suksesshme. Ju mund të shkarkoni paketën e aplikimit në faqen e web-it të Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim www.partnersalbania.org ose të kërkonit paketën e aplikimit duke dërguar email në adresat: ehaska@partnersalbania.org dhe jalite@partnersalbania.org.

Tabela e Përmbajtjes

1. SKEMA E NËN-GRANTIMIT E PROJEKTIT EMBRACE	4
1.1. HYRJE	4
1.2. SPECIFIKIME TË THIRRJES PËR PROJEKT PROPOZIME	5
1.3. ALOKIMI FINANCIAR I MUNDËSUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTUES	5
2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME	5
2.1. KRITERET E PRANUESHMËRISË	6
2.1.1. Pranueshmëria e Aplikantëve	6
NUMRI I GRANTEVE PËR APLIKANT DHE BASHKË-APLIKANT	6
2.1.2. Aktivitetet e Pranueshme	6
2.1.3. Kostot e Pranueshme: Kostot që mund të përfshihen	8
2.2. SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQNI.....	10
Dokumentat Mbështetës.....	10
Ku dhe Si të dërgohen Aplikimet	10
Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve.....	11
Informacione të tjera për aplikimet.....	11
2.3. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE	11
HAPA 1: HAPJA & KONTROLLI ADMINISTRATIV	11
HAPI 2: VLERËSIMI I APLIKIMIT TË PLOTË	13
HAPI 3: VERIFIKIMI I PRANUESHMËRISË SË APLIKANTËVE DHE BASHKË-APLIKANTËVE (nëse ka)	14
HAPI 4: NJOFTIMI PËR VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES	15
HAPI 5: FAZA E KONTRAKTIMIT	15
3. KALENDARI INDIKATIV I PROCESIT	16
4. LISTA E ANEKSEVE	16

1. SKEMA E NËN - GRANTIMIT E PROJEKTIT EMBRACE

1.1. HYRJE

Projekti “EMBRACE – Modele Sipërmarrëse që Ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese” (këtu i referuar si projekti “EMBRACE”) zbatohet nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në partneritet me Project Ahead dhe financohet nga BE, përmes Delegacionit të BE-së, në kuadër të komponentit Mbështetja për Shoqërinë Civile – IPA Civil Society Facility and Media Programme 2016-2017.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë sociale duke fuqizuar zhvillimin gjithëpërfshirës në vend. Më specifikisht, projekti do të krijojë modele të suksesshme të ndërmarrjeve sociale të qëndrueshme dhe do të nxisë përmirësimin e mjedisit ligjor dhe praktik që mundëson burime financimi të qëndrueshme për OSHC-të. Me qëllim prodhimin e rezultateve të pritshme dhe arritjen e objektivave specifik, projekti do të ketë një qasje me pjesëmarrje dhe do të integrojë një seri aktivitetesh.

OSHC-të dhe ndërmarrjet sociale janë përfituesit kryesorë të projektit duke qenë se janë pak të njohura në publik si dhe zotërojnë kapacitete të ulëta zbatuese, probleme përsa i përket varësisë ndaj donatorëve dhe vështirësi për të ndikuar në vendimmarrje. Ka një numër të limituar të OSHC-ve në eksplorimin e mundësive alternative të financimit si angazhimi në aktivitet ekonomik, dhurimet nga biznesi dhe iniciativa të sipërmarrjes sociale. Megjithatë, të ardhurat nga këto aktivitete luajnë një rol jo të qenësishëm në qëndrueshmërinë financiare dhe nuk bazohen në një strategji afatgjatë dhe të qartë të gjenerimit të të ardhurave. Duke marrë në konsideratë situatën, projekti i propozuar do të përmirësojë situatën e OSHC-ve dhe ndërmarrjeve sociale për të filluar/fuqizuar iniciativat e sipërmarrjes sociale. Nëpërmjet projektit do të mundësohet përmirësimi i kuptimit dhe procesit të politikëbërjes nga ana e institucioneve publike përmes bërjes së propozimeve konkrete dhe rekomandimeve të politikave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për OSHC-të dhe ndërmarrjet sociale. Promovimi dhe mundësimi i një sektori të shoqërisë civile financiarisht të qëndrueshëm përmes identifikimit dhe aplikimit të burimeve alternative të financimit nga OSHC-të dhe fuqizimi i iniciativave të sipërmarrjes sociale do të kontribuojë në krijimin e ekonomisë sociale dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Bashkë me përpjekjet advokuese për krijimin e një mjedisi mundësues që promovon dhe mbështet iniciativat sipërmarrëse, projekti do të japë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e OSHC-ve duke rritur kapacitetet e tyre në këtë drejtim; duke ofruar mbështetje financiare ndaj iniciativave të reja dhe ekzistuese të sipërmarrjes sociale; aplikimit të eventeve risi në ngritjen e fondeve duke përdorur dhurime nga sektori privat; dhe garantimin e përfshirjes së tyre në rrjete ndërkombëtare për akses në financim dhe mundësi partneriteti si dhe rritjen e vizibilitetit të tyre ndaj sektorit të biznesit në vend.

Komponenti kryesor i projektit është *skema e nën-grantimit* për të ofruar mbështetje financiare ndaj organizatave jofitimprurëse në Shqipëri për zbatimin e iniciativave të reja dhe ekzistuese të sipërmarrjes sociale për të kontribuar më tej në krijimin e ekonomisë sociale në vend.

Buxheti total i vendosur në dispozicion për OSHC-të është **101,000 Euro**. Kjo shumë do të shpërndahet në tre raunde grantesh. Buxheti total për raundin e tretë do të jetë **20,600 Euro**.

Deri në tre (3) organizata të shoqërisë civile do të mbështeten përmes raundit të tretë të skemës së

nën - grantimit të projektit EMBRACE.

Objektivi specifik i kësaj thirrje për projekt - propozime është: Mbështetja e krijimit të iniciativave të reja të sipërmarrjes sociale si dhe fuqizimi i atyre ekzistuese, që kontribuojnë në rritjen e përfshirjes sociale, përmes integritit, punësimit dhe zhvillimit ekonomik të komunitetit lokal. Përmes kësaj thirrje për projekt - propozime, OSHC-të e interesuara mund të aplikojnë për të zbatuar një projekt të mbështetur përmes skemës së nën - grantimit të projektit EMBRACE.

1.2. SPECIFIKIME TË THIRRJES PËR PROJEKT PROPOZIME

Partnerët Shqipëri fton të gjitha organizatat e shoqërisë civile që kanë një ide sipërmarrëse inovative, ose ato OSHC që janë duke implementuar aktualisht një iniciativë të sipërmarrjes sociale të aplikojnë në këtë thirrje për projekt - propozime.

Thirrja aktuale për projekt - propozime kërkon të mbështesë OSHC-të kudo në Shqipëri, të cilat kanë një ide biznesi ose ato që kanë krijuar një sipërmarrje sociale dhe kanë si qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe qendrueshmërinë e kësaj iniciative. Duke qenë se qëllimi kryesor i projektit EMBRACE është mbështetja e ideve inovative të sipërmarrjes sociale dhe fuqizimin e atyre ekzistuese që kontribuojnë në rritjen e përfshirjes sociale përmes integritit, punësimit, dhe zhvillimit ekonomik të komunitetit lokal, OSHC-të përmes aplikimeve të tyre duhet të prezantojnë modele të iniciativave sipërmarrëse sociale, si një motor real i zhvillimit për ekonominë sociale në zonat ku zbatohet projekti.

Aplikantët duhet të tregojnë qartësisht në projekt - propozim sesi planifikojnë të garantojnë qendrueshmërinë e produkteve/shërbimeve që do të zhvillohen dhe shiten, pas periudhës së zbatimit të projektit. Krijimi i partneriteteve dhe rrjetëzimit në nivel lokal me grupe interesi të ndryshme në zonën e targetuar, si një indikator i qendrueshëm i projektit inkurajohet të realizohet në këtë thirrje për projekt – propozime.

1.3. ALOKIMI FINANCIAR I MUNDËSUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Shuma e përgjithshme indikative në dispozicion për këtë raund të tretë të Thirrjes për Propozime është **20,600 EURO**. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet në dispozicion.

Madhësia e Grantit: Çdo grant i kërkuar në kuadër të kësaj thirrje për projekt - propozime duhet të jetë midis këtyre shumave minimale dhe maksimale:

Shuma Minimale: 3,000 EURO

Shuma Maksimale: 7,000 EURO

2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e aktiviteteve të financuara në kuadër të raundit të tretë të Thirrjes për Propozime, në përputhje me Udhëzuesin për Manaxhimin e Granteve për të kontraktuar procedurat për veprimet, i cili është i zbatueshëm për këtë thirrje.

2.1. KRITERET E PRANUESHMËRISË

(1) Aktorët: Ka tre sete të kritereve të pranueshmërisë, që lidhen me:

Aplikanti, entiteti i cili dërgon formën e aplikimit; dhe **Bashkë-aplikanti**, nëse ka (2.1.1);

(2) Projekti:

Projekti për të cilin mund të jepet mbështetja financiare nëpërmjet grant - dhënies (2.1.2.);

(3) Kostot:

Llojet e kostove që mund të merren në konsideratë në përcaktimin e shumës së grantit (2.1.3)

2.1.1. Pranueshmëria e Aplikantëve

Me qëllim që të pranoheni për një grant, aplikanti duhet:

- (1) Të jetë një person juridik;
- (2) Të jetë një organizatë e shoqërisë civile, e regjistruar si një OJF, sipas legjislacionit shqiptar për organizatat jofitimprurëse;
- (3) Të jetë themeluar dhe të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- (4) Mos të jetë e përfshirë në veprimtari fetare dhe/ose aktivitete të partive politike;
- (5) Mos të ketë precedent ligjor në mashtrim apo korrupsion.

Aplikanti mund të aplikojë vetëm ose në partneritet me një Bashkë - aplikant. Bashkë - aplikantët potencial duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë (1); (2); and (3); (4); (5) të cilat janë të aplikueshme dhe për vetë aplikantin. Kostot e tyre janë të pranueshme ose jo në të njëjtën mënyrë si ato të shkaktuara nga aplikanti kryesor (Shih sesionin 2.1.3 - Kostot e Pranueshme).

NUMRI I GRANTEVE PËR APLIKANT DHE BASHKË - APLIKANT

Për shkak të specifikimeve të thirrjes, Autoriteti Kontraktues do të aplikojë kushtet e mëposhme:

Një organizatë duhet të dorëzojë **vetëm një aplikim** në kuadër të kësaj thirrje për projekt-propozime.

Një organizatë mund të dërgojë **vetëm një aplikim** në kuadër të Thirrjes për Projekt-Propozime: ose si Aplikant ose si Bashkë – Aplikant;

Një organizatë mund të fitojë vetëm një grant në kuadër të Thirrjes për Projekt – Propozime;

Një aplikim nuk mund të ketë më shumë se një aplikant dhe një bashkë-aplikant.

2.1.2. Aktivitetet e Pranueshme

Kohëzgjatja: Kohëzgjatja e projekteve të financuara në këtë thirrje për projekt - propozime nuk mund të jetë më pak se **9 muaj** dhe më shumë se **12 muaj**.

Vendndodhja: Aktivitetet mund të zbatohen në gjithë Shqipërinë.

Llojet e aktiviteteve: Strategjitë e propozuara duhet të fokusohen në përmbushjen e rezultateve kundrejt objektivave të vendosura në sesionin 1 dhe duhet të përfshijnë, por jo të limitohen në:

Aktivite që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve lokale ku projekti do të zbatohet;

- Aktivite që mobilizojnë punën dhe ekspertizën e burimeve lokale dhe traditës në komunitetet e tyre;
- Aktivite që krijojnë kohezion lokal dhe fuqizojnë gjithëpërfshirjen dhe lidhjet midis njerëzve dhe komunitetit;
- Aktivite që nxisin integrimin dhe punësimin, veçanërisht të grupeve të marxhinalizuara.

Aktivite jo të pranueshme: Llojet e mëposhtme të aktiviteteve janë të papranueshme për këtë mbështetje financiare:

- Vetëm rikonstrukcion infrastrukture dhe/ose blerje pajisjesh;
- Aktivite të lidhura vetëm ose kryesisht me bursa individuale për pjesëmarrje në workshope, seminare, konferenca, kongrese;
- Aktivite të lidhura vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- Aktivite që adresojnë çështje vetëm ose kryesisht të ndërgjegjësimit të komunitetit dhe/ose fushata advokacie;
- Projekte që konsistojnë tërësisht ose në pjesën më të madhe në punë përgatitore ose studime;
- Projekte që mbështesin parti politike ose aktivitete ilegale, dhe aktivitete fetare;
- Financim bazë i aplikantëve ose (ku është relevante) i partnerëve të tij;
- Mbulimin e humbjeve dhe kapital i krijuar nga dhurimet;
- Subvencionim i organizatave të tjera;
- Blerje të tokës, ndërtesave dhe zyrave;
- Shpenzime të prapambetura për projekte që janë në implementim ose të përfunduara;
- Aktivite që zhvillohen jashtë Shqipërisë;
- Aktivite Humanitare.

Mbështetje financiare ndaj palëve të treta: Në kuadër të kësaj thirrjeje, aplikantët nuk mund të ofrojnë mbështetje financiare/grante ndaj palëve të treta.

Procedurat për dhënien e kontratës: Kur zbatimi i projektit kërkon lidhjen e një kontrate prokurimi, përfituesi duhet t'ia japë kontratën ofertës ekonomikisht më të leverdisshme, pra ofertës që ofron vlerën më të mirë të parave, duke respektuar parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të kontraktorëve potencialë dhe të sigurojë që nuk ka konflikt interesi.

Monitorimi dhe Vlerësimi: Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të miratuara do të realizohet nga Autoriteti Kontraktues.

Vizibiliteti: Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të publikuar/ paraqitur faktin që Bashkimi Evropian është financuesi i nismave/projekteve nëpërmjet projektit EMBRACE.

Propozimet që janë pjesërisht ose tërësisht të financuara nga Bashkimi Evropian duhet të përmbajnë informacion dhe aktivitete komunikuese të hartuara për të rritur ndërgjegjësimin e

publikut rreth qëllimeve të aktiviteteve të projektit dhe të mbështetjes së Bashkimit Evropian në nivel lokal apo rajonal si dhe rezultatin dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje.

Aplikantët duhet të veprojnë në përputhje me objektivat dhe prioritetet dhe të garantojnë vizibilitetin e financimit të Bashkimit Evropian (shih manualin për komunikim dhe vizibilitet për veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian të specifikuar dhe publikuar nga Komisioni Evropian në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/communication-visibility-requirements-2018_en.pdf

2.1.3. Kostot e Pranueshme: Kostot që mund të përfshihen

Vetëm ‘**kostot e pranueshme**’ mund të mbulohen nga një grant. Kategoritë e kostove që janë të pranueshme dhe jo të pranueshme paraqiten më poshtë. Buxheti i prezantuar është konsideruar si një paraqitje e kostove dhe një tavan për ‘kostot e pranueshme’.

Rimbursimi i kostove të pranueshme mund të bazohet në buxhetin e rënë dakort të specifikuar në njësi dhe kosto për njësi.

Në Aneksin B, Forma e Propozimit të Buxhetit, në kolonën e dytë të fletës së punës nr. 2, “Arsyetimi i kostove të paraqitura” për çdo zë ose linjë të buxhetit aplikanti duhet të:

Përshkruajë informacionin dhe metodat e përdorura për të përcaktuar koston për njësi, kostot e padetajuara (lump sums) dhe/ose normat fikse (flat rates), të kostove që ju referohen; Shpjegojë qartë formulat e përdorura për llogaritjen e shumave finale të lejueshme.¹

Në fazën e kontratës, Autoriteti Kontraktues vendos nëse do të pranojë shumat e propozuara ose normat në bazë të buxhetit fillestar të paraqitur nga aplikanti, duke analizuar të dhënat faktike të granteve të kryera nga aplikuesi ose nga projekte të ngjashme.

Rekomandimet për të dhënë një grant janë gjithmonë subjekt i kontrollit paraprak për gabime të mundshme në buxhet (siç mund të jenë gabime aritmetike, pasaktësi, kosto joreale, kosto jo të pranueshme etj). Kontrollat mund të çojnë në kërkesa për sqarime dhe Autoriteti Kontraktues zotëron të drejtën për të bërë ndryshime ose reduktime për të adresuar gabimet apo pasaktësitë. Si rezultat i ketyre korigjimeve, nuk është e mundur që të rritet granti ose përqindja e financimit nga Autoriteti Kontraktues.

Prandaj, është në interesin e aplikantit të hartojë një buxhet **realist dhe me kosto-efektive**.

Kostot e pranueshme:

Kostot e pranueshme janë kostot aktuale të shkaktuara nga përfituesi (t) që plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

Kostot që kryhen gjatë zbatimit të projektit:

Kostot në lidhje me shërbimet dhe punët duhet të lidhen me aktivitetet e kryera gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

¹Shembuj:- Kostot e stafit llogariten: Numri i orëve të punës ose ditët e punës * koston / ditë ose orë pune, ose kosto/muaj përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi në rastin e stafit të angazhuar në zbatimin e projektit;-Kostot e udhëtimeve: distance në km* kosto e transportit / km; numri i ditëve * kompesimin ditor paraprakisht sipas vendit; - për kosto specifike që rrjedhin nga organizimi i një eventit: numri i pjesëmarrësve * koston totale të parashikuar për cdo pjesëmarrës; etj.

Kostot që lidhen me furnizimet duhet të lidhen me shpërndarjen dhe instalimin e artikujve gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Nënshkrimi i një kontrate, një porosie, ose çdo angazhimi për ofrimin në të ardhmen të shërbimeve, punëve ose pajisjeve pas përfundimit të periudhës së zbatimit të projektit nuk përfshihen tek kostot e pranueshme;

Shpenzimet e kryera duhet të paguhën para datës së mbylljes së projektit.

- Kostot janë përfshirë në buxhetin e përgjithshëm të projektit;
- Kostot janë të domosdoshme për zbatimin e projektit;
- Kostot janë të verifikueshme dhe të identifikueshme, veçanërisht ato regjistrohen në librat e kontabilitetit të përfuturit dhe përcaktohen në përputhje me standartet shqiptare të kontabilitetit dhe me praktikën e zakonshme të kontabilizimit të kostove të zbatuesit (ve) të projektit;
- Kostot janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit fiskal dhe sigurimet shoqërore;
- Kostot janë të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar, në veçanti për sa i përket anës ekonomike dhe eficiencës.
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) konsiderohet një kosto e pranueshme.

Kontributet në natyrë:

Kontributi në natyrë do të thotë ofrimi i të mirave ose shërbimeve falas nga një palë e tretë për zbatuesin e projektit. Meqënëse kontributet në natyrë nuk përfshijnë ndonjë shpenzim për zbatuesin, ato nuk janë kosto të pranueshme për këtë aplikim.

Bashkë - financimi. Koncepti i bashkë - financimit nuk është i aplikueshëm për përfuturit e granteve në kuadër të kësaj thirrjeje për projekt-propozime. Skema e nëngrantimit do të mbulojë 100% të buxhetit total të projektit brenda limiteve të kërkuara.

Kostot e Papranueshme. Kostot e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- doganat dhe tarifat e importit, ose çdo detyrim tjetër;
- blerje, qera ose huamarrje të tokës dhe të ndërtesave ekzistuese, përveçse nëse zyrat duhet të merren me qera dhe kur është e qartë se duhet për të mundësuar zbatimin e projektit (duhet të demonstronhet nga aplikanti);
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- pajisje të përdorura;
- komisionet bankare (përveç kostove të mirëmbajtjes së llogarisë bankare), shpenzimet e garancive dhe detyrime të ngjashme;
- shpenzime për këmbime, detyrime dhe humbje në këmbim që lidhen me ndonjë komponent specifik të llogarisë në euro, si dhe shpenzime të tjera të pastra financiare;
- kontributi në natyrë;
- shpenzime të qerave (leasing);
- shpenzime amortizimi;
- borxhet dhe komisionet për trajtimin e borxhit
- borxhe dhe interesa të borxhit;
- dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- shpenzimet e deklaruara nga zbatuesi dhe të mbuluara nga një projekt apo program tjetër;
- kredi për të tretët

- taksat, me përjashtim të taksës së vlerës së shtuar, nëse kushtet e mëposhtme janë plotësuar:
 - (a) nuk janë të kthyeshme në asnjë mënyrë;
 - (b) është përcaktuar që ato të përballohen nga përfituesit përfundimtar; dhe
 - (c) janë qartësisht të identifikueshëm në projekt propozim;

(Shënim: Tatimi mbi të Ardhurat Personale për punonjësit konsiderohet si kosto e lejueshme nën këtë thirrje për propozime)

2.2. SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET TË NDIQNI

Paketa e Aplikimeve duhet të dorëzohet në përputhje me udhëzimet në Thirrjen për Propozime. Aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet në Formën e Aplikimit të Grantit si aneks me Udhëzuesin (Aneksi A).

Aplikantët duhet të përgatiten dhe dorëzojnë aplikimet e tyre **në gjuhën shqipe**.

Çdo gabim apo mospërputhje në lidhje me pikat e renditura në udhëzim për formularët e aplikimit (p.sh. nëse shumat në fletët e punës të buxhetit janë të ndryshme) mund të çojnë në refuzimin e aplikimit. Sqarime do të kërkohen vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë duke e penguar Autoritetin Kontraktues të bëjë një vlerësim objektiv.

Aplikimet e shkruara me shkrim dore nuk do të pranohen.

Propozimi i projektit duhet të përgatitet duke ndjekur udhëzimet e aplikimit dhe formatet e publikuara (formën e aplikimit, buxhetin, kornizën logjike, etj.). Prandaj është e rëndësishme që këto dokumente të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës lidhur me projektin.

Dokumentat Mbështetës

Dokumentat mbështetëse dorëzuar me aplikimin (**aplikanti dhe bashkë-aplikanti**, nëse ka) duhet të përfshijnë:

Vendimi i regjistrimit në gjykatë (Kopje);

Çertifikata e Regjistrimit e lëshuar nga gjykata me përditësimet më të fundit, jo më e vjetër se 3 muaj (Origjinale);

Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (Kopje);

Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (Kopje);

Vërtetim i pagesës së detyrimeve të tatimeve (që tregon që ska detyrime) (Origjinale);

Pasqyra e vitit të fundit financiar të organizatës (Kopje);

Dokumenti i lëshuar nga Gjykata që vërteton që organizata nuk ka çështje pezull, jo më e vjetër se 3 muaj (Origjinale);

Dokumenti i lëshuar nga Prokuroria që vërteton që organizata nuk ka çështje pezull, jo më e vjetër se 3 muaj (Origjinale);

Ku dhe Si të dërgohen Aplikimet

Forma e plotë e aplikimit, korniza logjike duhet të dorëzohet në formë elektronike në format wordi, ndërsa buxheti duhet të dorëzohet në format excel.

Lista verifikuese për Formën e Aplikimit të Grantit (Sesioni 15 i formës së aplikimit të grantit) duhet të jetë pjesë e dosjes elektronike. Deklarata e Aplikantit dhe Bashkë - Aplikantit (nëse ka)

(Sesioni 16 dhe 17) duhet të plotësohet, firmoset dhe vuloset dhe të dërgohet elektronikisht në pdf.

Dokumentat mbështetës duhet të dorëzohen elektronikisht në format pdf.

Paketa e aplikimeve bashkë me dokumentat mbështetës duhet të dërgohen **vetëm elektronikisht** në adresat: ehaska@partnersalbania.org dhe jalite@partnersalbania.org

Konfirmim i marrjes së aplikimit – një email konfirmues do të dërgohet çdo aplikanti për të konfirmuar marrjen e aplikimit.

Aplikantët duhet të verifikojnë aplikimet e tyre nëse janë të plota dhe përdorin Listën e Verifikimit të Formës së Aplikimit. Aplikimet e paplota dhe që nuk plotësojnë rregullat e vendosura do të refuzohen.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **data 4 shkurt 2020**, brenda orës **17:00** me orën lokale. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit të përcaktuar do të refuzohet automatikisht.

Informacione të tjera për aplikimet

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail **jo më vonë se 21 ditë para afatit të fundit** për dorëzimin e aplikimeve në adresën e mëposhtme, duke vendosur qartësisht numrin referent të Thirrjes për Projekt - Propozime:

Partnerët Shqipëri si Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime ndaj pyetjeve të dërguara pas kësaj date.

Përgjigjet do të jepen jo më vonë se **11 ditë pas afatit të fundit** për dërgimin e aplikimeve. Për të garantuar një trajtim të barabartë të aplikantëve, Partnerët Shqipëri nuk mund të japë një opinion paraprak mbi pranueshmërinë e aplikantëve, projektin apo aktivitetet specifike.
Adresa e Emailit: ehaska@partnersalbania.org;

Pyetjet që mund të jenë me interes dhe në shërbim edhe për aplikantët e tjerë, së bashku me përgjigjet, do të publikohen në faqen e internetit të Partnerëve Shqipëri: www.partnersalbania.org. Prandaj, është e këshillueshme që rregullisht të konsultoheni me faqen e internetit në fjalë në mënyrë që të jeni të informuar për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

2.3. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Ekipi i Manaxhimit të Projektit EMBRACE dhe Komiteti i Vlerësimit të Grantëve. Të gjitha projekt - propozimet e bëra nga aplikantët do të vlerësohen sipas kritereve dhe hapave të mëposhtëm.

HAPI 1: HAPJA & KONTROLLI ADMINISTRATIV

Më poshtë do të vlerësohen:

- Pajtueshmëria me dorëzimin brenda **Afatit Kohor** të përcaktuar. Nëse afati kohor nuk është përmbushur, aplikimi do të refuzohet automatikisht.

- Forma e Aplikimit të Grantit duhet të plotësojë të gjitha kriteret e specifikuar në listën e kriterëve të pranueshme.

Nëse njëri nga informacionet e kërkuara mungon ose është i pasaktë, aplikimi mund të refuzohet *vetëm* mbi këtë bazë dhe aplikimi nuk do të vlerësohet më tej.

Përgjigja për secilën nga pyetjet e mëposhtme duhet të jetë PO në mënyrë që projekti të jetë i pranueshëm dhe të kalojë për vlerësim të mëtejshëm--Vlerësimin Intensiv të bazuar në pikët dhe peshën specifike.

Kriteret Administrative:	Po	Jo	Komentet
1. Propozimi është paraqitur brenda afatit			
2. Për këtë Thirrje për Propozime janë përdorur të gjithë formularët e aplikimit të publikuar në udhëzim			
3. Propozimi është i shtypur			
4. Propozimi është në shqip			
Kriteret e pranueshmërisë:	Po	Jo	Komentet
<p>1. Pranueshmëria e Aplikantit (aplikant dhe bashkë-aplikanti, nëse ka):</p> <p>Vendimi i regjistrimit në Gjykatë (kopje);</p> <p>Çertifikata e Regjistrimit e lëshuar nga gjykata me përditësimet më të fundit, jo më e vjetër se 3 muaj (Origjinal);</p> <p>Statuti dhe Akti i Themelimit të organizatës (kopje);</p> <p>Regjistrimi në Zyrën e Tatim-Taksave (NIPT) (kopje);</p> <p>Vërtetim i pagesës së detyrimeve të tatimeve (jo borxh) (Origjinale);</p> <p>Pasqyra e vitit të fundit financiar (1) e organizatës (kopje);</p> <p>Dokumenti i lëshuar nga Gjykata që vërteton që organizata nuk ka çështje pezull, jo më e vjetër se 3 muaj (Origjinale);</p> <p>Dokumenti i lëshuar nga Prokuroria që vërteton që organizata nuk ka çështje pezull, jo më e vjetër se 3 muaj (Origjinale);</p>			
2. Limitet e buxhetit të projektit: Buxheti total i projektit është brenda limiteve të kërkuara (minimumi 3,000 Euro dhe maksimumi 7,000 Euro)			
3. Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë nga 9 muaj në 12 muaj.			

4. Aplikanti ka paraqitur vetëm një aplikim (ose si Aplikant, ose si Bashkë-Aplikant).			
--	--	--	--

Pas vlerësimit të pranueshmërisë, Partnerët Shqipëri do të dërgojë një letër për secilin aplikant ku do të informohen nëse aplikimet e tyre janë dërguar brenda afateve, nëse pranueshmëria është vlerësuar, dhe rezultatet e këtij vlerësimi. Komiteti Vlerësues i Granteve do të procedojë me aplikantët të cilët kanë kaluar fazën e kontrollit administrativ.

HAPI 2: VLERËSIMI I APLIKIMIT TË PLOTË

Cilësia e aplikimeve, duke përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit të plotë që janë në tabelën më poshtë. Ka dy lloje kriteresh: kriteret e përzgjedhjes dhe të akordimit të grantit.

Kriteret përzgjedhëse ndihmojnë vlerësimin e kapacitetit operacional dhe financiar të aplikantit me qëllim garantimin që ata:

- Kanë burime të qendrueshme dhe të mjaftueshme financiare për të mbajtur aktivitetin e tyre gjatë periudhës së cilës do të zbatohet projekti;
- Kanë kapacitet bazik manaxherial, kompetenca profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për të plotësuar projektin e propozuar me sukses.

Kriteret e akordimit të grantit ndihmojnë vlerësimin e cilësisë së aplikimeve në përputhje me objektivat dhe prioritetet, dhe akordimin e granteve për projekte, të cilat maksimizojnë efektivitetin e përgjithshëm të kësaj Thirrje për Projekt-Propozime. Këto kriteret ndihmojnë të përzgjidhen aplikimet për të cilat Autoriteti Kontraktues ka besim që janë në përputhje me objektivat dhe prioritetet. Ato mbulojnë rëndësinë (relevancën) e projekt-propozimit, konsistencën me objektivat e Thirrjes për Projekt - Propozime, cilësinë, impaktin e pritshëm, qendrueshmërinë dhe efektivitetin e kostos.

Pikëzimi:

Tabela e vlerësimit ndahet në sesione dhe nënsesione. Çdo nënsesioni do të jepet një pikëzim midis 1 dhe 5 si më poshtë: 1=shumë dobët; 2=dobët; 3=mjaftueshëm; 4=mirë; 5=shumë mirë.

SESIONI	PIKËT MAKSIMALE
1. RELEVANCA	20
1.1. Sa relevant është propozimi me objektivat dhe specifikimet e Thirrjes për Propozime?	5x2*
1.2. Sa relevant është propozimi ndaj nevojave dhe kufizimeve të rajonit të targetuar dhe atyre të përfshirë (grupet e targetuara dhe përfituesit)? A janë përcaktuar qartë nevojat dhe a i adreson propozimi në mënyrën e duhur?	5x2*
2. Kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit dhe bashkë-aplikantit (nëse ka) në zbatimin e projekt - propozimit	20
2.1. A ka Aplikanti eksperiencë të mjaftueshme të provuar në manaxhimin e projekteve të ngjashme me projektin e propozuar?	5
2.2. A ka Aplikanti eksperiencën dhe kapacitetet e mjaftueshme	5

në manaxhimin e projekteve të së njëjtës madhësi granti?	
2.3. A ka stafi i propozuar ekspertizën teknike të mjaftueshme dhe aftësitë për të implementuar projektin?	5
2.4. A ka Aplikanti sisteme operacionale (rregulla dhe procedura financiare dhe administrative) që mbështesin manaxhimin e suksesshëm të projektit?	5
3. Efektiviteti dhe zbatueshmëria e projektit	30
3.1. Janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike, dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritura?	5
3.2. Është plani i veprimit i qartë dhe i zbatueshëm?	5x2*
3.3. A përmban propozimi indikatorë objektivisht të verifikueshëm për rezultatet e projektit?	5
3.4. A promovon projekti përfshirjen sociale dhe/ose zhvillimin ekonomik përmes integritit dhe punësimit, veçanërisht të grupeve të marginalizuara, ose mobilizimin e punës & ekspertizës së burimeve lokale?	5x2*
4. Qendrueshmëria e projektit	15
4.1. A ka projekti një ndikim të prekshëm në grupet e targetuara dhe përfituesit e tij (<i>a impakton projekti pozitivisht zonën e përfshirë dhe komunitetin lokal dhe ky impakt është qartësisht i përshkruar dhe matur</i>)?	5
4.2. A janë rezultatet e pritshme të projektit të propozuar financiarisht të qendrueshme? (<i>Si do të vetë-financohen dhe/ose financohen aktivitetet pasi financimi të mbarojë?</i>)	5
4.4. A janë aktivitetet e propozuara për qendrueshmërinë e projektit realiste dhe koherente?	5
5. Buxheti dhe efektiviteti i kostove të projektit	15
5.1. A janë aktivitetet e reflektuara në mënyrën e duhur në buxhet?	5x2*
5.2. A është raporti ndërmjet kostove të paraqitura dhe rezultateve të pritshme i kënaqshëm?	5
PIKËT TOTALE MAKSIMALE	100

*këto pikë shumëzohen me 2 për shkak të rëndësisë së tyre

Vlerësimi

Pas vlerësimit, do të përgatitet një tabelë duke listuar aplikimet e radhitura sipas pikëve të marra dhe brenda shumës së fondeve në dispozicion. Aplikimi me pikët më të larta do të përzgjidhet. Veç kësaj, një listë rezervë do të përgatitet duke ndjekur të njëjtat kritere e cila do të përdoret gjatë Verifikimit të Pranueshmërisë së Aplikantëve dhe Bashkë - Aplikantëve nëse vihet re mungesë dokumentash mbështetës ose ndonjë mospërputhshmëri midis Deklaratës së Aplikantit dhe dokumentave mbështetës.

HAPI 3: VERIFIKIMI I PRANUESHMËRISË SË APLIKANTËVE DHE BASHKË-APLIKANTËVE (nëse ka)

Verifikimi i pranueshmërisë, bazuar në dokumentat mbështetës të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues (shih sesionin 2.2) do të realizohet vetëm për aplikimin që është përzgjedhur sipas pikëve brenda fondit në dispozicion për grantet e projektit EMBRACE.

Deklarata e Aplikantit (Sesioni 16 i formës së aplikimit të grantit) do të verifikohet me dokumentat mbështetës të dorëzuara nga aplikanti dhe bashkë-aplikanti.

Çdo dokument mbështetës që mungon ose çdo mospërputhje mes Deklaratës nga Aplikanti dhe dokumentave mbështetës mund të çojë në refuzim të aplikimit mbi këtë bazë të vetme.

Pranueshmëria e aplikantëve dhe projekti do të verifikohen sipas kritereve të vendosura në Sesionin 2.1.1, 2.1.2 dhe 2.1.3. Çdo aplikim i refuzuar do të zëvendësohet nga aplikimi tjetër më i mirë në listën rezervën që është brenda fondit në dispozicion.

HAPI 4: NJOFTIMI PËR VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Aplikantët do të njoftohen me shkrim për vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e paraqitur dhe, nëse është refuzuar, arsyet e refuzimit. Kjo letër do të dërgohet me e-mail.

Një aplikant që beson se është vlerësuar negativisht si rezultat i ndonjë gabimi apo parregullsie gjatë procesit të vlerësimit mund të bëjë ankimim brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) nga dita që ka marrë njoftim/ letrën e refuzimit/ ose emaili i dërguar. Komiteti i Vlerësimit të Granteve do të konsiderojë ankesat. Ankimimi do të shyrtohet dhe përgjigja do të kthehet brenda 5 ditëve (ditë pune) që nga paraqitja e ankimit.

HAPI 5: FAZA E KONTRAKTIMIT

Procesi i kontraktimit do të kalojë në hapat e mëposhtëm:

1. Negocimi

Para nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të negociuar me aplikuesin në mënyrë që të:

Sigurojë eficientë e kostove të veprimit;
Sigurojë një ekuilibër të drejtë midis kostove operacionale dhe jo operacionale;
Reflektojë kostot reale të tregut;
Reflektojë kostot në përputhje me aktivitetet e propozuara

Pikat e negocimit nuk duhet të ndryshojnë në asnjë mënyrë pjesën e konsiderueshme të projektit të propozuar, por të jenë në përputhje me rregullat administrative / financiare / burimet njerëzore / programatike të BE-së dhe të Autoritetit Kontraktues.

Pas përfundimit të pikave të mësipërme, nënshkrimi i kontratës do të nënshkruhet ndërmjet aplikuesit përkatës dhe Autoritetit Kontraktues .

3. KALENDARI INDIKATIV I PROCESIT

	DATA	ORA
Shpallja publike e Thirrjes për Projekt - propozime	6 Janar 2020	-
Afati i fundit kohor për të kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktues	15 Janar 2020	17:00
Data e fundit në të cilën publikohen sqarimet nga Autoriteti Kontraktues	20 Janar 2020	17:00
Afati i fundit kohor për dërgimin e Aplikimeve	4 Shkurt 2020	17:00
Informimi i aplikantëve mbi hapjen e aplikimit dhe kontrollin administrativ	6 Shkurt 2020	-
Informimi i aplikantëve mbi vlerësimin e aplikimit të plotë	24 Shkurt 2019	-
Njoftimi për akordimin e granteve (pas kontrollit të pranueshmërisë)	6 Mars 2019	-
Firmosja e Kontratave	13 Mars 2019	-

4. LISTA E ANEKSEVE

DOKUMENTAT PËR TU PLOTËSUAR

- Aneksi A: Forma e Aplikimit të Grantit (Format Word)
Aneksi B: Forma e Propozimit të Buxhetit (Format Excel)
Aneksi C: Forma e Kornizës Logjike (Format Word)